

Pikat e mbyllura të rendit të ditës

Muaji	Dhjetor 2019	Janar 2020	Shkurt 2020	Mars 2020	Prill 2020	Maj 2020	Qershor 2020	Korrik 2020	Gusht 2020
	5	2	3	/	/	/	4	2	5

Tabela 5: Pikat e mbyllura të rendit të ditës të paraqitura për secilin muaj të monitorimit.

## ANËTARËT MË AKTIVË TË KËSHILLIT GJYQËSOR

Anëtarët më aktiv gjatë mbledhjeve të KGjK-së

1	Makifete Saliuka
2	Avni Mehmeti
3	Qerim Ademaj
4	Manushe Karaqi

Tabela 6: Anëtarët më aktiv në mbledhjet e KGjK-së.

Aktiviteti i anëtarëve të KGjK-së në këto takime është vlerësuar në bazë të asaj se sa herë kanë diskutuar gjatë takimit dhe nëse diskutimi i tyre ka qenë relevant me pikat e agjendës së ditës.

## PËRKTHIMI GJATË MBLEDHJEVE TË KGjK-SË

Përkthimi gjatë mbledhjeve të KGjK-së

Muaji	Dhjetor 2019	Janar 2020	Shkurt 2020	Mars 2020	Prill 2020	Maj 2020	Qershor 2020	Korrik 2020	Gusht 2020
PO	2	1	1	1	1	1	1	1	1
JO	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Tabela 7: Sigurimi përkthimit në mbledhjet e KGjK-së.

Në takimet e monitoruara direkt të muajve dhjetor, janar dhe shkurt, ka pasur përkthim në gjuhën shqipe dhe atë serbe. E njëjta vlen edhe për muajt pasues, ku sipas informatave të marra nga KGjK qasja në përkthim është siguruar për të gjithë anëtarët.

## MBAJTJA E PROCESVERBALEVE TË TAKIMEVE

Sa u përket procesverbaleve të takimeve të KGjK-së nga monitorimi ynë është vërejtur se ato janë mbajtur për takimet e muajit dhjetor, janar dhe shkurt. Ndërkaq, për të gjitha takimet që nuk janë monitoruar si dhe ato që janë monitoruar nga platforma ZOOM,<sup>5</sup> FOL përmes kërkesës për informata zyrtare drejtuar KGjK-së, është informuar se për secilin takim të KGjK-së është mbajtur procesverbal.

## PUBLIKIMI I VENDIMEVE QË VIJNË NGA TAKIMET E KGjK-SË

Ligi për Këshillin Gjyqësor të Kosovës përcakton se vendimet dhe të gjitha politikat e miratuara nga takimet e Këshillit duhet të publikohen në faqen zyrtare të KGjK-së brenda pesë ditëve nga miratimi i tyre.<sup>6</sup> KGjK gjatë periudhës së monitorimit dhjetor 2019 - gusht 2020, kryesisht i ka publikuar vendimet me kohë, përveç vendimeve të takimeve të muajve qershor dhe gusht. Më poshtë është paraqitur numri i vendimeve që janë nxjerrë nga takimet e KGjK-së, të cilat janë monitoruar nga FOL.

Datat e takimeve të KGjK-së	Datat e publikimit të vendimeve nga takimet e KGjK-së	Numri i vendimeve të publikuara
12.12.2019	16.12.2020 dhe 20.12.2020	16
24.12.2019	27.12.2020	12
27.01.2020	27.01.2020	19
21.02.2020	21.02.2020	22
12.03.2020	15.03.2020	2
10.04.2020	10.04.2020	13
30.04.2020	30.04.2020	7
29.05.2020	30.06.2020	5
23.06.2020	02.07.2020 dhe 01.07.2020	72
03.07.2020	03.07.2020	6
06.08.2020	21.08.2020	8

Tabela 8: Numri i vendimeve të publikuara dhe datat e publikimit në faqen zyrtare të KGjK-së.

<sup>5</sup> Për shkak të rrethanave të krijuara nga pandemia e COVID-19,

<sup>6</sup> Ky Ligj nuk specifikon që afati pesëditor për publikimin e vendimeve në faqen zyrtare nënkupton afatin pesë ditë pune ose jo.



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA

**FOL**



## PROGRAMI PËR FUQIZIMIN E SISTEMIT TË DREJTËSISË

### MONITORIMI I TAKIMEVE TË KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

DHJETOR 2019 - GUSHT 2020

## GJETJET NGA MONITORIMI I TAKIMEVE TË KGJK-SË

### NUMRI I TAKIMEVE TË KGJK-SË

KGJK gjatë kësaj periudhe të monitorimit ka mbajtur gjithsej 11 takime. Nga këto takime, pesë janë monitoruar direkt ndërsa, për shkak të situatës së krijuar nga pandemia e COVID-19, gjashtë takimet e tjera janë monitoruar online përmes platformës ZOOM.

Numri i takimeve të KGJK-së dhjetor 2019 - gusht 2020




Tabela 1: Takimet e KGJK-së gjatë periudhës së monitorimit dhjetor 2019 – gusht 2020.

### PUBLIKIMI I AGJENDËS BRENDA AFATIT KOHOR

Prej nëntë agjendave të shpallura në faqen e internetit të KGJK-së, vetëm një është publikuar në kohë ashtu siç e obligon Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës,<sup>3</sup> ndërsa një nuk është publikuar fare. Në anën tjetër, njëjtë sikur në periudhën monitoruese paraprake, KGJK ka vazhduar t'i publikojë agjendat në gjuhën shqipe dhe serbe.

Publikimi i agjendës në faqen e internetit të KGJK-së

Muaji	Dhjetor 2019	Janar 2020	Shkurt 2020	Mars 2020	Prill 2020	Maj 2020	Qershor 2020	Korrik 2020	Gusht 2020
Është publikuar me kohë	1								
Nuk është publikuar me kohë	1	1	1		2	2	0	1	1
Nuk është publikuar fare				1					

Tabela 2: Publikimi i agjendave brenda afatit ligjor në faqen zyrtare të KGJK-së.

3 Këshilli Gjyqësor i Kosovës. LIGJI Nr. 06/L 055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Dhjetor 2018.

## NUMRI I ANËTARËVE TË PRANISHËM NË TAKIMET E KGJK-SË

Gjatë kësaj periudhe të monitorimit, të gjithë anëtarët e Këshillit Gjyqësor të Kosovës kanë qenë të pranishëm në takimet e monitoruara nga FOL.<sup>4</sup>

Pjesëmarrja e anëtarëve në takimet e KGJK-së

Muaji	Dhjetor 2019	Janar 2020	Shkurt 2020	Mars 2020	Prill 2020	Maj 2020	Qershor 2020	Korrik 2020	Gusht 2020
Të pranishëm	10	9	9	11	/	/	/	11	11
Munguan	0	0	0	0	/	/	/	0	0

Tabela 3: Pjesëmarrja e anëtarëve në takimet e KGJK-së.

## MESATARJA E VONESAVE TË TAKIMEVE TË KGJK-SË

Mesatarja e vonesave të takimeve të KGJK-së është 15 minuta, apo 10 minuta më shumë krahasuar me periudhën paraprake të monitorimit. Në tabelën e mëposhtme nga llogaritja e mesatares së vonesave janë përjashtuar katër (4) takime, të cilat nuk janë monitoruar si rezultat i rrethanave të krijuara nga COVID-19.

Vonesat e takimeve të KGJK-së

Datat e takimeve të KGJK-së	12.12.2019	24.12.2019	27.01.2020	21.02.2020	13.03.2020	10.04.2020	30.04.2020	29.05.2020	23.06.2020	03.07.2020	06.07.2020
Vonesat e shprehura në minuta	7	7	10	19	/	/	/	/	20	20	20

Tabela 4: Vonesat e takimeve të KGJK-së të shprehura në minuta.

## APROVIMI I RENDIT TË DITËS

Në të gjitha mbledhjet e KGJK-së rendi i ditës është miratuar nga të gjithë anëtarët.

4 KGJK përbëhet nga 11 anëtarë. Kjo përbërje e Këshillit ka pasur ndryshime gjatë muajve dhjetor 2019 dhe janar 2020 për shkak të dorëheqjes së dy anëtarëve.

Lëvizja FOL (FOL) dhe BIRN Kosova (BIRN) me mbështetjen e Programit të USAID për Fuqizimin e Sistemit të Drejtësisë nga muaji maj 2019 kanë monitoruar takimet dhe vendimet e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) për të vlerësuar pajtueshmërinë dhe nivelin e transparencës me Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës<sup>1</sup>. Përpilimi i borshures është bërë përmes metodës së monitorimit direkt të takimeve të KGJK-së dhe mbarëvajtjes së tyre si dhe të faqes zyrtare të internetit të KGJK-së, ku është monitoruar nëse procesverbalet, vendimet, dhe rregulloret janë publikuar pas takimeve të Këshillit.

Gjatë periudhës së dytë të monitorimit dhjetor 2019 - gusht 2020, KGJK ka mbajtur 11 takime në të cilat të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.<sup>2</sup> Një gjë e tillë nuk është vërejtur gjatë periudhës së parë të monitorimit (maj-nëntor 2019), ku vetëm në një (1) nga tetë (8) takimet e monitoruara ishin të pranishëm të gjithë anëtarët. Për takimet e mbajtura në periudhën e dytë të monitorimit, të gjitha agjendat janë publikuar në gjuhën shqipe dhe serbe. Nga këto agjenda, vetëm njëra është publikuar me kohë. Mesatarja e vonesave të takimeve të KGJK-së ka qenë 15 minuta apo 10 minuta më shumë krahasuar me periudhën paraprake të monitorimit. Anëtarët më aktivë gjatë kësaj periudhe të monitorimit ishin Makifete Saliuka, Avni Mehmeti, Qerim Ademaj dhe Manushe Karaqi. Në të gjitha takimet e KGJK-së janë mbajtur procesverbale. Kurse sa u përket vendimeve që kanë dalë nga këto takime, kryesisht janë publikuar me kohë në faqen zyrtare të KGJK-së, përveç vendimeve të takimeve të muajve qershor dhe gusht 2020.

1 Këshilli Gjyqësor i Kosovës. LIGJI Nr. 06/L 055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Dhjetor 2018.

2 Për shkak të rrethanave të krijuara nga pandemia e COVID-19, FOL dhe BIRN nuk i kanë monitoruar takimet e KGJK-së të muajve mars, prill dhe maj, ndërsa takimet e muajve qershor, korrik dhe gusht janë monitoruar përmes platformës ZOOM.